

VENDIM
Nr. 477, datë 13.7.2022

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 501, DATË 29.8.2018, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR EKSPERTËT E
OBJEKTEVE TË PRONËSISË INDUSTRIALE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 198/b, 198/c, 198/ç dhe 202, të ligjit nr. 9947, datë 7.7.2008, “Për pronësinë industriale”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kudo në tekstin e rregullores “Për ekspertët e objekteve të pronësisë industriale”, miratuar me vendimin nr. 501, datë 29.8.2018, të Këshillit Ministrave, fjalët: “të licencohet”, “licencim”, “t’u licencuar”, “licencimit”, “licencën”, “licencë”, “licenca”, “licencës” zëvendësohen, përkatësisht, me fjalët “të certifikohet”, “certifikim”, “t’u certifikuar”, “certifikimit”, “certifikatën”, “certifikatë”, “certifikata”, “certifikatës”.

2. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj